

Miratim në lidhje me kryerjen e rregullt të testeve për COVID-19, teste që mund të bëhen vetë, në vitin shkollor 2021/22

Kryerja e rregullt e testeve për COVID-19 (testet antigen dhe PCR), të cilat mund të bëhen vetë, kërkon pëlqimin e personit që do të testohet ose, në rastin e fëmijëve shkollorë deri në moshën 14 vjeç, të personit me të drejtë kujdestarie. Ky miratim vlen për kryerjen e rregullt të testeve vetëbërëse antigen dhe PCR në shkollë në vitin shkollor 2021/22, si dhe përsa u takon testeve PCR edhe për përpunimin e të dhënave të mëposhtme:

- *Emrin dhe mbiemrin e nxënësit ose nxënëses, si dhe klasën në të cilën shkon*
- *Të dhënat kontaktuese të personit me të drejtë kujdestarie (numër telefoni dhe e-mail)*
- *Numrin e shishkës testuese (= Numri përmbi etiketën e librezës testuese për Koronën)*
- *Rezultatit e testit*

Vërejtje: Një lidhje e të dhënave të nxënësit, nxënëses ose personit me të drejtë kujdestarie me rezultatit laboratorik për një test të caktuar ndodh vetëm në rastet kur në shkollë ka një rezultat pozitiv. Rezultatet e testeve shuhën një javë pasi ato kanë arritur në shkollë.

Si kryhen testet vetëbërëse PCR për COVID-19 :

- Testet PCR bëhen në shkollë duke e shpëlarë vazhdimisht gojën për 30 sekonda (Solucioni shpëlarës përbëhet nga kripë gjelle që përdoret për ushqim dhe ujë i pijshëm).
- Çdo nxënës apo nxënëse merr një fletë me kodet e tij personale QR.
- Menjëherë pas çdo testimi nxënësi apo nxënësjë e ngjit një figurë me një kod QR mbi shishkën e tij ose të saj (në kapakun e shishkës).
- Një lidhje direkte me një nxënës apo nxënëse konkrete nuk mund të vendoset në ambientet jashtë shkollës së tyre.
- Shishkat testuese dërgohen në një laborator të certifikuar për vlerësimin e testeve së bashku me informacionin se cilës shkollë i përkasin. Laboratori i dërgon shkollës një raport me numrin e përgjithshëm të testeve që janë kryer atje dhe vë në dukje ato kode QR të cilët është vërtetuar ekzistenca e virusit COVID-19.
- Shkolla mund të përcaktojë se cilit nxënës apo cilës nxënëse i përkasin kodet QR me rezultat pozitiv.
- Në rastin e një rezultati pozitiv shkolla lajmëron menjëherë nxënësin apo nxënësen, si dhe personat me të drejtë kujdestarie. Sipas paragrafit 3 të Kapitullit të parë të Ligjit për Epideminë rezultatet pozitive të testeve duhet t'i bëhen të ditura Institucionit të Shëndetit.
- Rezultati negativ i testit shënohet në librezën testuese për Koronën që ka nxënësi apo nxënësjë.

Detaje të tjera rreth testit vetëbërës PCR mund të gjeni te:

www.bmbwf.gv.at/allesspuelt

Detaje rreth testit vetëbërës antigen për COVID-19 mund të gjeni te:

www.bmbwf.gv.at/selbsttest

Informacione të mëtejshme për Mbrojtjen e të Dhënave në kuadër të BMBWF mund të gjeni te:

www.bmbwf.gv.at/datenschutzschulen

Einwilligung für die regelmäßige Durchführung von COVID-19-Selbsttests im Schuljahr 2021/22 -
Albanisch

DEKLARATË MIRATIMI

Unë, (emri dhe mbiemri), që mund të më kontaktoni nëpërmjet
këtij numri (numri i telefonit) dhe (adresa
e e-mailit), jap pëlqimin që unë, respektivisht fëmija im nën moshën 14 vjeç,
.....(emri dhe mbiemri)

- të mund të kryejë, përkatësisht të kryejë një test vetëbërës antigen për COVID-19 (pa marrë material në pjesën e pasme të hundës ose fytit)
- të mund të kryejë, respektivisht të kryejë një test vetëbërës PCR për COVID-19 (me anë të shpëlarjes së gojës) dhe që të dhënat e mësipërme të përpunohen në shkolla me qëllimin e përmendur më sipër për vetëtestim.

Vendi, data

Nënshkrimi i nxënësit, nxënëses ose përfaqësuesit a përfaqësueses ligjore

Emri (me gërma të mëdha shtypi)

Anullimi i Miratimit:

Anullimi i këtij miratimi për mbrojtjen ligjore të të dhënave, si dhe i miratimit për marrjen e provave për testin PCR ose testin antigen është i mundur në çdo kohë vetëm me shkrim në shkollë (me postë, e-mail ose faks). Nëpërmjet anulimit të miratimit nuk preket legjitimiteti i masave të marra dhe i përpunimit të të dhënave që janë kryer më parë. Nga çasti i anulimit nuk kryhen më në shkollë testime, të cilat i nënshtrohen anulimit.

Jeni të lutur t'ia jepni Deklaratën e Miratimit, pasi ta keni nënshkruar, fëmijës suaj për ta çuar në shkollë. Ajo ruhet atje.